



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 640/2 prot.

Tiranë, më 24. 05. 2024

### V E N D I M

**Nr. 152, datë 24. 05. 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën<sup>3</sup> nr. 93 regj., datë 30.04.2024, të shtetasit D. M., kundër Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë (Bordit të Disiplinës), Gjykatave dhe institucioneve të tjera të shtetit shqiptar (Patronazhistët) dhe televizionit Top Channel (Emisionit investigativ “Fiks Fare”) me pretendimin e diskriminimit për “shkak të etnisë, bindjeve politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, vendbanimit, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>4</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, D. M., theksohet ndër të tjera se: “Për më shumë se tre vjet gjendem në situatë të rëndë, ku veç të tjerave jam pre e diskriminimit të vazhdueshëm të paraqitura në lloje e forma të ndryshme, nga segmente kriminal, individ të veshur me poste e pushtet, nga struktura, segmente e instanca të rëndësishme të vendit. Dikush apo disa duket që janë shumë të interesuar ndaj meje dhe licencës sime si noter, të cilën e kam fituar me meritokraci dhe vetëm në saj të aftësive të mia individuale dhe profesionale.

Aktualisht, edhe më tepër për shkak dhe të ankimeve të mia ndaj segmenteve abuzues, skenarët e turpshëm të telenovelave të këtyre njerëzve nuk kanë të sosur, vijnë në mënyrë të pashtershme kundrejt meje. Saga e diskriminimit vazhdon, kësaj here tashmë e transferuar nga

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Plotësuar përmes e-mail-it datë 19.05.2024.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

*gjykatat dhe zyrat e shtetit në publik të gjerë, për diskriminimin tim individual dhe profesional duke manipuluar masën.*

*Më herët kam paraqitur një ankesë e cila është rregjistruar pranë jush me Nr. 12, datë 17.01.2023, me subjekt ankues: D. M., paraqitur kundër: Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë (Bordit të Disiplinës), Gjykatës dhe institucione të tjera të shtetit shqiptar (Patronazhistët), për të cilën jeni shprehur me vendimin Nr. 29, datë 14.02.2023, për mospranimin e saj për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë.*

*Aktualisht për këtë ankesë të dytë të paraqitur pranë institucionit tuaj, marrë shkas nga disinformimi i qëllimshëm me paramendim i çështjes nga disa media vizive kombëtare, killer media e Top Channel me programin e saj gjobëvënës, satirik të Nastradinit gazetar, e ashtuquajtur “Fiks Fare”, ku në mënyrë të njëanshme, abuzive dhe arbitrare, kanë paraqitur apriori çështjen duke publikuar informacione false, fakte dhe deklarata të pavërteta e mashtruese duke manipuluar masën. Ky disinformim diskriminues është bërë me paramendim për llogari dhe me dirigjim të subjekteve që kanë kryer diskriminimin të përmendur në pikën 2 të këtij ankimi. Pseudo-gazetarët e këtyre mediave vizive, aspak profesionale, në shkelje të ligjit dhe krejt të njëanshëm për publikimin në fjalë, madje në shkelje të plotë të rregullave profesionale gazetareske dhe Kodit të Etikes për mosparaqitje të informacionit të plotë dhe të analizës së fakteve të çështjes për gjendjen reale të palëve, por duke abuzuar me fuqinë që u jep media dhe të veshur me petkun e gazetarit, disinformuan në mënyrë të qëllimshme, paraqitën dhe shpërndanë imazhin e ankuesit pa dijeninë dhe aprovimin e tij në opinionin mbarë publik në mënyrë të pakontrolluar, apriori dhe duke u përpjekur haptazi të japin imazhin më të keq për ankuesin në opinionin e gjerë, për të diskretituar ankuesin dhe manipuluar masën.*

*Mosprofesionalizmi i këtyre mediave me apo pa qëllim nëpërmjet disinformimit të situatës konkrete në të cilën gjenden palët, ka synuar haptazi të dëmtojë dhe diskriminojë ankuesin, duke sjellë impakt negativ dhe njëkohësisht duke cënuar e kërcënuar rendë jetën private dhe profesionale të ankuesit, pa dijeninë, aprovimin e pëlqimin e ankuesit, duke vjedhur foto të ankuesit, me tendencë prishjen e imazhit, reputacionin, klientelën, dinjitetin, integritetin e tij në familje dhe në shoqëri, si dhe diskriminim të hapur në publik.*

*Këto reklama dhe njoftime diskriminuese të kësaj killer media, me qëllim diskriminimi kanë sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për ankuesin, që përbën formën më të rëndë të diskriminimit.*

*Pasi kjo media ka hedhur vrer e ka thënë një mijë të zeza, në mënyrë të njëanshme, vetëm për ankuesin duke u përpjekur ta veshin me petk të zi jo vetëm për prishje e zbehje imazhi dhe diskriminim në opinionin publik, por edhe për dëmtim material në të njëjtën kohë (duke larguar klientelën dhe duke e nxitur qëllimisht negativisht atë kundër noterit), e duke vazhduar më tej me ekzpozimin jo vetëm të fotos, por duke bërë publik numrin e telefonit personal pa dijeninë dhe pëlqimin e ankuesit, duke e vënë kështu jo vetëm në presion të rëndë para publikut, por duke e vënë edhe në qendër të shantazhit të hapur dhe kërcënimit nga kushdo. Këto media po keq përdoren nga segmente dhe individë me qëllime e synime dashakeqe, diskriminuese, të cilët përpos veprimeve antiligjore të çdo lloj forme dhe mënyre (për rreth 3 vjet), ndër të tjera po*

*paguajnë për të shitur licencën profesionale të ankuesit e cila ka statusin e pronësisë intelektuale, e inkorporuar në vetë personin tim për shkak të cilësive të posaçme që më ka dhuruar natyra për ti pasur, prirjeve, dhuntisë natyrore e intelektuale, hyjnore dhe formimit profesional e akademik dhe nuk mund të preket nga askush, të cilën e kam fituar vetëm në saje të aftësive dhe meritokracisë, pa dhurim, pa para, pa miq, pa hatër e pa qoka.*

*Paraqitja e rastit në këtë lloj forme e formati, na bën të mendojmë që vetë media nga ana e saj po paguhet nga këto segmente dhe individ kaq të interesuar për këtë rast. Madje duket jo e paguar, por e mirëpaguar, nisur nga fakti i zgjedhjes së transmetimit, skenarit të programit, qëllimi i të cilit duket që është goditja dhe diskriminimi i hapur i ankuesit në publik si individ dhe profesionist, ku për ta bërë sa më të besueshëm qëllimin, plotësohet me intervistën e stisur dhe aspak profesionale të dhënë nga M. S.; kohës së vënë në dispozicion që do të merrte përcjellja e informacionit të përgatitur sipas të të interesuarve të vërtetë, bazuar në ditën dhe orën e transmetimit (orar i mirëzgjedhur para Big Brotherit, ku dihet që audiencia është shumë e lartë), kështu që paraqitja e rastit nga media për disinformim ndaj noterit duket qartë që ka kuotim dhe koeficient tepër të lartë.*

*Përsa i përket veprimeve të kryera nga këto killer media, veprime të cilat u paraqitën të nxituara, disinformuese, keqdashëse, kërcënuese, të mirë paramenduara dashakeqësisht, të paligjshme dhe apriori, ishin dhe mbeten diskriminim dhe shantazh i hapur ndaj ankuesit, pa marrë parasysh çdo lloj dëmi psikologjik, fizik, moral, profesional dhe material që kanë shkaktuar nga disinformimi i qëllimshëm.*

*Siç faktohet kjo killer media nuk respekton parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive sipas ligjit për mediat audiovizive (neni 33).*

- *Referuar sa më sipër, kjo killer media duke vepruar në mënyrë të njëanshme dhe jo objektive, ka cenuar rëndë reputacionin, dinjitetin dhe të drejtat themelore të ankuesit, duke publikuar deklarata të pavërteta, mashtruese dhe informacione false.*
- *Ka cenuar rëndë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në programin e transmetuar prej saj, e garantuar nga neni 8 i Konventës Europiane.*
- *Ka cenuar rëndë, duke mos respektuar të drejtat e autorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të (siç është titulli noter e cila garantohet dhe mbrohet si pronësi intelektuale nga Konventa Europiane, neni 1 i protokollit nr. 1 dhe Kushtetuta).*

*Veprimet e kësaj media janë dëm i shkaktuar nga një sulm i pajustificuar ndaj reputacionit të ankuesit. Kjo media në abuzim me lajmin, qëllimin e vetëm e ka për komercialitet, gjobënie, duke manipuluar publikun në cenim të drejtave themelore të njeriut, reputacionin, pronën intelektuale, jetën private dhe profesionale, e cila ndaj ankuesit ka cenuar të dhënat e tij duke shfrytëzuar me fshehtësi edhe përmbajtje të fotografive dhe numrin e telefonit personal pa vënë në dijeni dhe pa marrë pëlqimin paraprak të ankuesit.*

*Kjo media ka cenuar rëndë jetën private të ankuesit, ku publikimi i një fotografie dhe numrit të telefonit personal në përgjithësi përbën një ndërhyrje më thelbësore në të drejtën e privatësisë, duke e ekspozuar hapur para kujtudo dhe duke e vënë me qëllim para çdo shantazhi. Siç është*

*përmendur tashmë në pjesët e mësipërme, imazhet e marra pa pëlqimin paraprak të ankuesit dhe fshehurazi pa dijeninë e tij, rezultojnë me shkelje të së drejtës për privatësi.*

*Veprimet e fajshme të kësaj media kanë shkelur të drejtën për respektimin e jetës së ankuesit, duke pasur ndikim në jetën e tij private në një shkallë të konsiderueshme.*

*E drejta për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë përbëjnë kategori të drejtash kushtetuese të parashikuara, përkatësisht, në nenet 22 dhe 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Këto të drejta janë, gjithashtu, të garantuara në të njëjtin nivel normativ nëpërmjet Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në të cilën Shqipëria është palë (bazuar në nenet 8 dhe 10 të saj). Kjo media ka shkelur rëndë të drejtat themelore të ankuesit të garantuara nga Konventa Evropiane, Protokollet e saj, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetuta e vendit.*

*Mediat nuk kanë asnjë të drejtë të keqpërdorin detyrën dhe misionin e tyre për informimin e opinionit publik, me lajme të pavërteta apo të shtrembëruara duke përdorur akte të falsifikuara, për interesa të ngushta personale, apo për individ, struktura e segmente kushdo qofshin ata.*

*Kjo media keqpërdor interesin publik dhe u shërben pronarëve, botuesve ose interesave private të dikujt, në sajë të gjobëvënive dhe financimeve nga burime të dyshimta, siç lakohen nga shumë burime informative në lidhje me këtë media, ku kohët e fundit kjo killer media, Top Channel po vjedh paratë dhe taksat e shqiptarëve edhe nëpërmjet inceneratorëve.*

*Fuqia e kazanit si kjo killer media, me saktë gjobëvënia mediatike për ta manipuluar masën sa më shumë, pasi kazani nuk lëviz pa interes dhe para, përkundrazi kjo killer media dhe gazetarët e saj, madje gazetari i fiksit është i përfolur si shërbëtor dhe bashkëpunëtor i ish-sigurimit kriminal komunisto nazifashist, siç e citon Gj. Th. në Fjala e Lirë.*

*Edhe vetë fjala e M. S. në këtë prononcim la shumë për të dëshiruar, e cila dyshohet si bashkëpunëtorë në shumë abuzime si kryetare e DHKN. Qëndrimi i saj nuk ishte aspak profesional dhe i pabazuar në fakte e prova, për të cilat zonja në fjalë është në dijeni të plotë të gjendjes reale të palëve. Prononcimi i saj me deklaratat mashtruese, pavarësisht dijenisë së plotë që ajo ka për çështjen, jo vetëm që ishte tepër e njëanshme dhe haptazi kundër ankuesit, por në të njëjtën kohë fjala e saj u paraqit diskriminuese ndaj tij.*

*Madje M. S. për shkak të lidhjeve nepotike të saj me Kryetarin e Gjykatës së Lartë, S. S., i lidhur me të si kunati i saj, me reagimin e saj lë të kuptosh si e përfshirë në skema abuzive, që po ndikon negativisht në dhënien e drejtësisë në procesin gjyqësor në raport me çështjen time, duke marrë vendime arbitrare dhe aspak kushtetuese dhe me të drejtën, në cenim të shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës, ku kjo drejtësi e kapur dhe e korruptuar është konstatuar edhe nga raportet e DASH, BE, etj, pasoja të cilat po i vuajmë dhe ne në realizimin e të drejtave të shkelura në mënyrë abuzive nga autoritetet dhe të mohuara dhe nga gjyqësori. Në këto kushte ndihem tepër i fyer, i dëmtuar dhe i diskriminuar nga këto ndërmarrje brutale që burojnë nga njerëz të vegjël dhe aspak profesional që shfrytëzojnë fuqinë e postit dhe të kazanit mediatik për të arritur çdo lloj qëllimi personal apo të një grupimi të caktuar me interesa të ngushta.*

*Nisur nga sa më sipër ndihem i detyruar dhe për mua paraqitet shumë e domosdoshme dhe adekuate kjo ankesë pranë institucionit Tuaj, si i vetmi institucion në mbrotje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nga çdo lloj diskriminimi, fyerje e abuzimi të mundshëm, nga kushdo,*

me apo pa qëllim. Sqaroj që po cenohem në marrëdhënien profesionale dhe klientelën e zyrës, pasi:

- Ankuesi ka në proces ofrimin e vazhduar rishtazi të shërbimit noterial për klientelën.
- Ankuesi është privuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë nga aksesit në Platformën NISA, duke bllokuar punën profesionale të noterit, edhe pse kjo platformë është antikushtetuese dhe cenon pavarësinë dhe sovranitetin e noterit si profesion i lirë dhe individual për çdo noter në zyrën e vet (neni 1, 2, 4 të ligjit nr. 110/2018 për noterinë) si dhe cenon të dhënat dhe privatësinë personale. Unë ushtroj profesionin individualisht sipas titullit noter që kam fituar dhe jo në varësi nga dhoma, konform Kushtetutës dhe ligjit dhe s'ka pse aspak të cunohem dhe ndikohem nga dhoma me një platformë të tillë abuzive apo askush tjetër. Noteri me përgjegjësi individuale e menaxhon vetë punën e tij profesionale dhe në raport me klientelën s'ka asnjë lidhje apo varësi me dhomën apo dikë tjetër.
- Gjykata i ka refuzuar ankuesit të drejtën e numërimit të regjistrit noterial.
- Disa zyra vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe ato të regjistrimit të automjeteve, refuzojnë të bëjnë regjistrimin e dëshmive të trashëgimisë testamentare, të akteve të klientëve të zyrës noteriale.
- Duke pasur në vëmendje se të drejtat e ankuesit janë shkelur në lidhje me të drejtat e tij pronësore, pasi është shkelur Konventa Evropiane në lidhje me profesionin liberal si dhe, është shkelur Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës, në lidhje me të drejtat pronësore të ankuesit, i cili zbatohet për pronësinë intelektuale, siç është Titulli Noter (Profesionet e Lira) dhe Klientela...

Veprimet e kundërligjshme, abuzive dhe arbitrare të palës së paditur, por edhe të gjykatave të cilat janë të njëanshme dhe aspak të pavarura, të cilat edhe pse janë të vetëdijshme për procesin abuziv të palës së paditur, nuk bëjnë sigurimin e padisë dhe as nuk marrin parasysh kërkesën time për t'ju drejtuar juve që të marrin mendimin tuaj, gjë që janë shkak për dëme serioze të pariparueshëm, duke na çuar në cenimin e marrëdhënies profesionale, e cila është e garantuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Neni 1 i Protokollit nr. 1, të aplikuar në vendimet e kësaj gjykate si në çështjen time, si dhe Kushtetuta e Shqipërisë, e garantuar nga nenet 18, 49, 58 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke cenuar dhe marrëdhëniet e garantuara nga neni 11 i Kushtetutës, e cila garanton se, "Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike", gjë e cila ka sjellë bllokim të veprimtarisë profesionale, falimentim të profesionit me qëllim dashakeqës ndaj ankuesit, që kanë qëllim shitjen e licencës sime profesionale, ku ankuesi siguron jetesën e tij dhe të familjes nëpërmjet këtij profesioni.

Noteri konkuron në treg si operator ekonomik dhe në këto kushte cenohet parimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve, parim ky i cili gëzon mbrojtje të veçantë nga neni 11 dhe 18 i Kushtetutës.

Profesioni është pasaportë e përhershme e inkorporuar në individualitetin tim, prirje dhe dhunti natyrore, që nuk mund të cenohet dhe s'mund të ketë ndikim mbi titullin profesional i cili ka statusin e pronësisë intelektuale asnjë vendimmarrje.

*Mosreagimi në kohë dhe i paarsyeshëm i hallkave të gjyqësorit, në kundërshtim me Kushtetutën, ligjshmërinë, pavarësinë dhe paanshmërinë, lë shumë për të dëshiruar dhe po bëhet shkak për pasiguri juridike, shkelje të procesit të rregullt ligjor, mohim të drejtësisë dhe shkeljen e të drejtës për zgjidhje efektive, garanci këto themelore për të drejtat, të njohur nga Konventa Evropiane dhe ashtu siç garanton Konventa, që Ligjet kombëtare që u japin imunitet zyrtarëve publikë janë në kundërshtim me Konventën.*

*Profesioni është pasaportë e përhershme dhe është kategorikisht e papranueshme që licencat profesionale siç është titulli noter të mund të konsiderohen monopoli i Ministrisë apo kushdo qoftë, që ti trajtojë si mallra tregu që mund ti nxjerrë në ankande shitje. Ato garantojnë si nga Kushtetuta, Konventa Evropiane, neni 1 i protokollit nr. 1, si tituj me vlerë intelektuale dhe pronësore, me vlerë trashëgimore.”*

Në këtë kontekst, ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar për shkak të etnisë, bindjeve politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, vendbanimit, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë (Bordit të Disiplinës), Gjykatave dhe institucioneve të tjera të shtetit shqiptar (Patronazhistët) dhe televizionit Top Channel (Emisionit investigativ “Fiks Fare”).

Gjithashtu, ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit ndaj tij, si dhe:

- marrjen e masave për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur;
- detyrimin e medias Top Channel sh.a., të bëjë publikimin e përgënjeshtimit publik, si dhe të më dëmshpërblej për dëmin jopasuror, pasuror, në shumën 39 milion euro të shkaktuar si rezultat i fyerjes dhe shpifjes publike, shumë të cilën do ta çoj për bamirësi, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre.

Nëpërmjet e-mail-it të datës 13.05.2024, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues, të saktësojë dhe dokumentojë shkaqet e pretenduara të diskriminimit (etninë, bindjen politike, gjendjen ekonomike, gjendjen shoqërore, vendbanimin, përkatësinë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm lidhur me:

- si shkaqet e pretenduara të diskriminimit kanë sjellë trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues;
- sqarimin mbi veprimet apo mosveprimet e ndërmarra nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, lidhur me shkaqet e diskriminimit të pretenduara;
- sqarimin mbi institucionet e tjera të shtetit shqiptar të pretenduara në ankesë, cilat janë dhe çfarë veprimesh apo mosveprimesh kanë kryer dhe për cilin shkak.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike, subjekti ankues, me e-mail-et<sup>5</sup> datë 19.05.2024 dhe 20.05.2024, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “Siç e kam shpjeguar më herët, vendimmarrja e Ministrisë së Drejtësisë dhe Bordit si vegël e

<sup>5</sup> Protokolluar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 102/1 prot., datë 30.01.2024.

ministrisë, shkon përtej profesionit dhe është sajuar dhe inskenuar mbi bazën e një procesi tendencioz, me dokumenta të falsifikuar, fiktive dhe në mashtrim të ligjit, nga sekserë të ish-Ministres E. Gj., e prirur nga qëllime si: Motive politike; Shitjen (tjetërsimin) e pronësisë time intelektuale, siç është titulli noter; Mohimin pa arsye dhe shkak ligjor, të të drejtës sime për transferim në Tiranë ku dhe kam vendbanimin; Abuzimi me pozitën dominuese në tregun e lirë është diskriminuese, ku segmente të Ministrisë së Drejtësisë favorizojnë dhe mbrojnë noterë që janë në profesion në kundërshtim me ligjin, që janë të lidhur reciprokisht në raporte interesash.

Rivlerësimi i noterëve është një mjet presioni dhe abuzimi, dhe shkelja e nenit 10, pika 4 të ligjit nr. 110/2028 “Për Noterinë”, që citon se: “Vendimet në lidhje me numrin e përgjithshëm të pozicioneve nuk sjellin pasoja për licencat që u janë dhënë më parë noterëve”, duke nxjerrë në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore Urdhërin nr. 88 datë 23.2.2021 “Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve, zëvendësnoterëve, si dhe për çdo Bashki” dhe urdhërin nr. 87 nga ish-Ministria e Drejtësisë E. Gj., nuk janë tjetër, veçse abuzim i pastër dhe aferë korruptive e saj mbi bazën e të cilit nxjerr në pah fabrikimin e procedimit disiplinor ndaj meje i cili është i falsifikuar, i qëllimtë dhe i paramenduar, duke me shantazhuar hapur dhe drejtperdrejtë në shkelje flagrante të ligjit, duke shfrytëzuar postin si ministre dhe duke shtrirë kompetancat e saj përtej institucionit që drejtonte, siç është dhoma kombëtare e noterisë, me qëllim pazaresh, qokash dhe shitjen e licencave profesionale. Kjo është forma më e rëndë diskriminimit të kryer ndaj meje e bazuar në fakte dhe prova konkrete, ku mbajnë firmën dhe vulën e vetë ministres, si dhe vartësëve të ministres. Diskriminimi vjen në forma e mënyra të ndryshme, verbale e joverbale. Diskriminuese, fyese, denigruese dhe mospërfillëse që ndërsa provon dhe abuzimin e tyre ndaj meje, është dhe fakti që pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga ime drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterisë për tu pajisur me procesverbalet e dala prej tyre për çështjen time nga bordi, jo vetëm që nuk më vihen në dispozicion por nuk denjojnë të kthejnë as përgjigje e të më vënë në dijeni me asnjë lloj forme e komunikimi.

Profesioni është pasaportë e përhershme dhe është e papranueshme që autoritetet e vendit të na trajtojnë si kavie dhe qenie inferiore pa dinjitet dhe integritet moral, profesional dhe shoqëror. Kufijtë territorial janë përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji administrativ dhe nuk mund ti caktojë e miratojë E. Gj. siç ka nxjerrë urdhërin nr. 87 që është antikushtetues. Pra siç shihet, gjithçka është mashtrim si nga ministria ashtu dhe nga kryetarja e dhomës noterisë dhe procesi ndaj meje është fabrikuar me synim të vetëm për të hequr licencën edhe pse nuk kanë konstatuar asnjë shkelje apo masë disiplinore më të hershme ndaj meje si noter. Diskriminues është fakti që me raport të falsifikuar të hartuar, vulosur e firmosur në zyrat e Ministrisë së Drejtësisë, ku vetë ministrja bazohet mbi këtë raport të falsifikuar të cilën nuk e ka firmos as vetë ajo siç e kërkon ligji, duke nxjerrë vendime apriori për heqjen e licencës sime. Diskriminim mbi mua dhe profesionin tim, bazuar në shkelje flagrante të ligjit nga ana e ministres dhe vartësve të saj. Ministria dhe vartësit e saj kanë shkelur hapur mbi kuadrin ligjor shqiptar madje dhe mbi atë penal për të më hequr licencën time, në mënyrën më fyese, denigruese dhe diskriminuese, duke me shkaktuar pasoja të rënda, mentale, psikologjike, sociale, ekonomike, personale, e më tej.

**Lind pyetja?** Si ka mundësi brenda dy datave kjo palo ministre nxjerr e miraton gjithë grupin e urdhërave dhe akteve nënligjore përsa i përket ligjit për noterinë?!!! Të gjitha këto akte i gjeni në faqen e Dhomës Kombëtare të Noterisë. A nuk është absurditet dhe shkelje flagrante kjo?

Është kategorikisht e papranueshme dhe e paligjshme, madje e dënueshme, që licencat të mund të konsiderohen monopol i ministrit apo kushdo qoftë, që ti trajtojë si mallra tregu që mund ti nxjerrë e kuotojë në ankande shit-blerjeje. Ato janë tituj me vlerë intelektuale dhe pronësore dhe si të tillë duhen përcaktuar në ligjin për noterinë dhe jo të shiten lartë e poshtë a thua se është mall konsumi që shiten e blihen në pazar.

Ligjet kombëtare që u japin imunitet zyrtarëve publik kur ata shkelin ligjin dhe abuzojnë me veprime dhe mosveprime në emer të ligjit dhe duke shfrytëzuar postin politik që mbajnë, janë në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Dejtave të Njeriut.

Pas paraqitjes së ankimit pranë jush, krejt rastësisht jam njohur me Urdhërin Nr.101, datë 27.02.2024 “Për shpalljen e Vendit Vakant si Noter në Bashkinë Dibër”, të Ministrit të Drejtësisë U. M.

Ky urdhër është nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë në shkelje flagrante të ligjit, pa marrë formë të prerë vendimi dhe në të njëjtën kohë faton plotësisht shitjen e Licencës sime Profesionale të Noterit, kjo në vazhden haptazi të bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë me Gjykatat e vendit dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, nën tryshninë e vetë Ministrit.

Ky urdhër i nxjerrë nga Ministri, vë në dukje dhe konstaton një mori shkeljesh të parashikuara nga Ligji për Noterinë, ku një shkelje e shtuar është dhe mungesa e transparencës, për faktin se nuk është bërë publikimi i vendeve vakante për të gjithë Republikën e Shqipërisë, siç e parashikon ligji, por vetëm për Bashkinë Dibër, që konkretisht i përket vetëm licencës sime profesionale të Noterit.

Heqja e licensës sime, është një sagë veprimesh korruptive dhe në shkelje flagrante të ligjit. Heqja e licensës sime bazohet mbi një raport të falsifikuar të fabrikuar nga vartësit e ministres Gj., e firmosur prej saj dhe e mbështetur nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, është një proces jo-shiterrues koruptiv i kuotuar shumë lartë, i iniciuar nga ish ministrja E. Gj. dhe vazhdon dhe nga ministri aktual. Llogjika dhe analiza e fakteve e provave të çështjes sime, për vazhdimësinë e veprimeve për heqjen e licensës sime profesionale, të çon në këtë përfundim, jo vetëm nga kronologjia e veprimeve antiligjore në nivel ministror por edhe politik meqë i përkasin të njëjtës parti politike, partisë pushtet. Madje, ministria në këtë lojë në mënyrë krejt të paligjshme dhe arbitrare, në abuzim të plotë ka përdorur edhe ish drejtorin e DPPP A. Gj. me sekserët e tij, i cili është arrestuar për korrupsion e ryshfete edhe pse profesioni i noterit nuk ka asnjë lidhje me pastrimin e parave, punë për të cilën paguhen në atë institucion për atë punë, pasi pastrimi i parave as nuk fillon tek noteria dhe as nuk përfundon tek noteria dhe nuk ka mbetur pastrimi i parave të bëhet në Dibër apo tek noteri, por është vetë DPPP që bën pastrim parash në mes të Tiranës dhe ato e dinë shumë mirë ku fle ujku, por nuk ua mban të merren me punën e vet për të cilën paguhen. Unë jetoj vetëm me djersën dhe punën time të ndershme dhe për këtë jam shembull pozitiv në publikun ku njihem, si unë personalisht dhe familja ime, ku prindërit e mi kanë shërbyer për gjithë jetën me devotshmëri, pastërti në profesionin e tyre si mjekë dhe nuk



*mundet ca të korruptuar që jetojnë në kurriz të pislleqeve të njollosin figurën time dhe të familjarëve të mi.*

*Siç faktohet plotësisht dhe qartazi, veprimi i Ministrisë aktual të Drejtësisë me këtë urdhër është formalitet i kamufluar i radhës në emër të ligjit dhe manipulim i hapur, duke hedhur gurin e duke fshehur dorën, pasi vendi im është shitur më herët nga Ministri, siç provohen si indicie veprimet korruptive, për t'ia shitur një shtetasi që fare mirë mund ti thuash askushi dhe aspak noter, i cili është pajisur me diplomë të dyshimtë dhe me licencë noterit të blerë në Lezhë, bëhet fjalë për A. B., ashtu siç janë blerë me korrupsion licenca profesionale noteresh nga 80% e noterëve në Shqipëri nëpërmjet Ministrave të korruptuar në vite, të cilët e shohin si mundësi pasurimi dhe shlyerje qokash në formën më komode korrupsionin dhe trafikun me licencat profesionale.*

*Nga të gjithë veprimet e kryera deri tani duket qartë që gjithçka ka qenë dhe mbetet e mirëmenduar me paramendim të plotë dhe me një qëllim të vetëm shitja e licencës sime me çdo kusht dhe pa marrë parasysh asnjë pasojë.*

*Meqenëse ky dokument përbën një zhvillim të rëndësishëm të çështjes, po j'ua vëmë në dispozicion duke ia bashkëngjitur kësaj memo-je së bashku me akte të tjera.*

*Gjithashtu e gjeni në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2024/8/e3a8149d-8b90-4b0e-a27c-14698891c600>.*

*Bashkëngjitur do të gjeni rezultatet e provimit të noterisë, të shpallur nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2016, ku në listë gjenden aplikuesit fitues me 80 pikë e lartë dhe aplikantët jofitues poshtë vijës së shënuar. Në këtë listë gjenden dhe rezultatet e arritura nga z. A. B, i cili është jashtë listës së fituesve, konkretisht me 31 pikë. Pavarësisht rezultateve të arritura z. A.B, punon si Noter në Lezhë dhe sot po kjo ministri po kujdeset dhe po i bën gati vendin e noterit, ekzaktësisht vendin tim të cilin e kam fituar vetëm bazuar në meritokraci dhe në përputhje të plotë me ligjin, pa hatëre, pa miq, pa qoka e pa ryshfete korruptive.*

*Së fundi, me keqardhje shpreh që me gjithë hapat e ligjshme të ndërmarra nga unë ankuesi për një periudhë 3 - 4 vjeçare për të gjetur zgjidhje brenda kuadrit ligjor shqiptar janë të pamundura, madje vihet re, duket qartë dhe hapur që Ministria e Drejtësisë, Gjykatat që u mungon pavarësia dhe paanshmëria, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe vetë Ministri shtuar dhe median kombëtare të kapur nga pushteti e politika janë në bashkëpunim dhe koherencë të plotë me njëri - tjetrin, ku mbizotëron jo vetëm nepotizmi, por edhe njohjet dhe interesat reciproke, duket qartë që çdo mjet ligjor në vendin tim ka shteruar në shqyrtimin e drejtë dhe në zgjidhje të paanshme të çështjes sime.*

*Unë jam i vetëpunësuar në profesionin e noterit mbi bazën e një titulli noter të fituar me meritë që ka statusin e pronësisë intelektuale, dhe operoj në tregun e lirë në kushtet e ekonomisë së lirë të tregut dhe është e papranueshme që me dokumente të falsifikuara dhe proces administrativ të fabrikuar të mund të bllokojnë punën time ministria, dhoma e noterisë, të përfshirë në afera korruptive, për të cilat në vijim do paraqes kallzim penal në SPAK, që duke përdorur dhe një media të quajtur killer media siç është Top Channel, e cila mbijeton në treg me gjobvënie, vjedhje të taksapaguesve shqiptar, e financuar nga inceneratorët dhe krimi...dhe një shërbëtores e politikës, pushtetit, abuzimit, dhe aspak interesit publik, duke manipuluar dhe*

disinformuar masën me publikime mashtruese, dhe informacione false si në rastin tim, me gazetarë që s'janë veçse bashkëpunëtorë e shërbëtorë të ish sigurimit.

Më poshtë gjeni linkun e medias Top Channel, që paraqet publikime mashtruese dhe informacione false: <https://www.youtube.com/watch?v=zBOqoHTqdCk>

Linku i medias Shijak Tv, ku unë ankuesi jam prononcuar kundër subjekteve që kanë kryer diskriminimin: [https://www.youtube.com/watch?v=cEyD\\_5kWJmA](https://www.youtube.com/watch?v=cEyD_5kWJmA)”.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, janë përcaktuar si shkaqe diskriminimi, etninë, bindjet politike, gjendjen ekonomike, gjendjen shoqërore, vendbanimin, përkatësinë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka

paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike apo shkaqeve të cituara në ankesë.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm të ankuesit, vijnë për shkaqet e pretenduara, duhet që fillimisht këto shkaqe të jenë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkaqe të njohura nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, janë: etnia, bindjet politike, gjendja ekonomike, gjendja shoqërore, vendbanimi, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër.

*Së pari*, sa i takon pretendimit të subjektit ankues për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh<sup>6</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohej mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh<sup>7</sup>.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon

---

<sup>6</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

<sup>7</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi<sup>8</sup> karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën subjekti ankues nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale, por referon si shkak pasojat që kanë ardhur si rezultat i shkeljeve apo moszbatimit të akteve ligjore apo nënligjore në fuqi. Sakaq, këto pretendime nuk lidhen me shkakun, cilësinë e veçantë apo ndonjë karakteristikë individuale specifike të ankuesit.

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese në radhë të parë duhet të provojë se, shkakun i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi apo grupi i personave i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura, duhet

---

<sup>8</sup> “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtura.

Pra, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

*Së dyti*, subjekti ankues, në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pretendon diskriminimin për shkak të etnisë, bindjeve politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, vendbanimit, përkatësisë në një grup të veçantë, duke i lidhur me veprimet dhe mosveprimet e subjekteve ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përrjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në mënyrë të shprehur në lidhje me shkakun e gjendjes arsimore, të pretenduar nga subjekti ankues si arsyeja ose shkakun për të cilën ai i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe të disfavorshëm.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë (Bordit të Disiplinës), Gjykatave dhe institucioneve të tjera të shtetit shqiptar (Patronazhistët) dhe televizionit Top Channel (Emisionit investigativ “Fiks Fare”), duke pretenduar se është gjendur në një situatë diskriminuese, situatë e cila supozohet se ka si shkaqe *etninë, bindjet politike, gjendjen ekonomike, gjendjen shoqërore, vendbanimin, përkatësinë në një grup të veçantë, si shkaqe diskriminimi*.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale, por referon si shkak pasojat që kanë ardhur si rezultat i shkeljeve apo

moszbatimit të akteve ligjore apo nënligjore në fuqi. Sakaq, këto pretendime nuk lidhen me shkakun, cilësinë e veçantë apo ndonjë karakteristikë individuale specifike të ankuesit.

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që subjekti ka paraqitur, nuk ka dhënë asnjë informacion shpjegues mbi shkaqet e pretenduara të diskriminimit. Komisioneri, vlerëson se, vetëm fakti që ankuesi ka cituar ato nuk provon në vetvete posedimin e tyre.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i subjektit ankuesi për diskriminim për shkak të etnisë, bindjeve politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, vendbanimit, përkatësisë në një grup të veçantë dhe “çdo shkak tjetër”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezulton i provuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

Pala ankuese nuk parashtrohet argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart shkaqet e pretenduara, mbi të cilat të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse D. M. është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë (Bordit të Disiplinës), Gjykatave dhe institucioneve të tjera të shtetit shqiptar (Patronazhistët) dhe televizionit Top Channel (Emisionit investigativ “Fiks Fare”), trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga etnia, bindjet politike, gjendja ekonomike, gjendja shoqërore, vendbanimi, përkatësia në një grup të veçantë dhe “çdo shkak tjetër”.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: .....ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues D. M., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: *etnia, bindjet politike, gjendja ekonomike, gjendja shoqërore, vendbanimi, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër*)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)